



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Sigurinë Kombëtare

PROCESVERBAL

Tiranë, më 10.10.2019, ora 11:00

Drejton mbledhjen:

Ermonela Felaj - kryetare e Komisionit

Rendi i ditës:

Shqyrtimi i projektligjit “Për masat shtrënguese ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”.

Marrin pjesë:

Ermonela Felaj, Sadi Vorpsi, Antoneta Dhima, Xhemal Qefalia, Lefter Maliqi, Alban Zeneli, Edmond Rrushi, Ylli Shehu, Arben Elezi, Elona Gjebrea, Luan Duzha, Anduel Xhindi, Myslym Murrizi, Nimet Musaj dhe Arlind Çaçani.

Mungojnë:

Luan Harusha, Elena Xhina dhe Paulin Sterkaj.

Të ftuar:

Etjen Xhafaj - Zëvendësministër për Europën dhe Punët e Jashtme

Shpresa Shahaj – Drejtor i Drejtorisë të së Drejtës Ndërkombëtare dhe Europiane

Arlinda Gjata – Specialiste në Drejtorinë e së Drejtës Ndërkombëtare dhe Europiane

HAPET MBLEDHJA

Ermonela Felaj – Mirëdita, kolegë!

Çelim mbledhjen e Komisionit të Sigurisë Kombëtare.

Sot në rendin e ditës kemi shqyrtimin në tërësi të projektligjit “Për masat shtrënguese ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”.

Për të prezantuar këtë projektligj kemi të ftuar zëvendësministrin për Europën dhe Punët e Jashtme, zotin Etjen Xhafaj, drejtoreshën e Drejtorisë të së Drejtës Ndërkombëtare dhe Europiane, zonjën Shpresa Shahaj dhe zonjën Arlinda Gjata, specialiste në Drejtorinë e së Drejtës Ndërkombëtare Europiane.

Për këtë projekt relatore është caktuar zonja Artemis Dralo. Besoj se relatimi i koleges sonë Dralo do të na ndihmojë që ta kuptojmë më shumë projektin. Zonja Dralo gjatë kohës kur kryente detyrën e zëvendësministres për Europën dhe Punët e Jashtme ka qenë edhe pjesë e grupit të punës për hartimin e këtij projektligji.

Kolegëve iu kujtoj se ne jemi komision përgjegjës për këtë projektligj. Ky është një projektligj i rëndësishëm, dhe është mirë që të kalohet si pjesë e të gjitha atyre projekteve që lidhen me paketën e integritetit evropian. Madje është pjesë e planit kombëtar për integrimin. Kështu që besoj se impenjimi i të gjithëve do të na ndihmojë që brenda ditës së sotme në këtë mbledhje ne mund ta mbyllim diskutimin e tij.

Në fillim, dua t’ia jap fjalën zotit Xhafaj për të bërë një prezantim të projektligjit dhe më pas zonjës Dralo.

Faleminderit!

Etjen Xhafaj – Faleminderit, zonja kryetare!

Të nderuar deputetë,

Sot kemi sjellë projektligjin “Për masat shtrënguese ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”. Qëllimi kryesor i këtij projektligji është vendosja dhe zbatimi i masave shtrënguese ndërkombëtare në funksion të ruajtjes së paqes dhe sigurisë, parandalimit të konflikteve ndërkombëtare, mbështetjes dhe forcimit të demokracisë, sundimit të ligjit dhe të drejtave të njeriut dhe arritjes së objektivave të tjerë të sigurisë kombëtare.

Masat shtrënguese ndërkombëtare janë një instrument teje kompleks i politikës së jashtme dhe vendosja e tyre është e detyrueshme për respektimin e parimeve ndërkombëtare si për sundimin e ligjit, ashtu edhe për mbrojtjen e të drejtave të njeriut. Iniciativa për të sjellë këtu këtë projektligj është në përputhje me detyrimin që Republika e Shqipërisë ka si vend anëtar i Kombeve të Bashkuara për zbatimin e rezolutave të OKB-së, në zbatim të kreut VII të

Kartës së Kombeve të Bashkuara. Gjithashtu, është në kuadër të rekomandimeve të task-forcës për veprim financiar, që ka rishikuar standardet ndërkombëtare për sa i përket luftës kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.

Gjithashtu, ky projektligj vjen edhe në vijim të gjetjeve të Komitetit të MONEYVAL, organizmit monitorues të Këshillit të Europës, që është në varësi të Komitetit të Ministrave të Këshillit të Europës, i cili ka sugjeruar që ne të kishim një mekanizëm, i cili tejkalon mekanizmat shtetërorë aktualë, të cilët kontrollojnë vetëm ato sanksione ndërkombëtare, të cilat kanë të bëjnë me çështjet e terrorizmit, të pastrimit të parave. Gjithashtu, ka sugjeruar për t'u shtrirë edhe në rezoluta të tjera, të cilat nuk kalohen vetëm nga Organizata e Kombeve të Bashkuara, por edhe nga Bashkimi European.

Ky projektligj kalon edhe në një hap tjetër: vendos miratimin dhe kalimin e sanksioneve të brendshme, pra të miratuara dhe të iniciuara nga Republika e Shqipërisë. Sipas të drejtës ndërkombëtare, çdo sanksion i vendosur nga Këshilli i Sigurimeve të Kombeve të Bashkuara është ligjërish i detyrueshëm për të gjitha shtetet, që duhet të marrin masa të menjëhershme për zbatimin. Me këtë projektligj Shqipëria u bashkohet vendimeve të Këshillit për masat shtrënguese të Bashkimit European, të cilat ndiqen në vijim të nenit 8 të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit nëpërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bashkimit European; MSA-ja e vitit 2006.

Aktualisht ka një boshllëk ligjor lidhur me masat shtrënguese që nuk lidhen me terrorizmin apo me financimin e tij, por që kanë të bëjnë me financimin e armëve të shkatërrimit në masë dhe me zbatimin e drejtpërdrejtë të rezolutave të dala nga kapitulli VII i Kartës së Kombeve të Bashkuara, me qëllim zbatimin nga Republika e Shqipërisë të masave ndërkombëtare të ndërmarra në kuadër të rezolutave të Këshillit të Sigurimit, natyra e të cilave nuk lidhet me terrorizmin apo me financimin e terrorizmit, ku është bërë edhe hartimi i këtij ligji, i cili do të shërbejë si bazë ligjore për implementimin e nismave të tjera.

Për hartimin e ligjit janë marrë në konsideratë eksperiencat jo vetëm nga vendet e rajonit, pra duke u nisur që nga Kosova, Maqedonia, Serbia dhe Kroacia, më pas kemi parë legjislacionet e si Çekisë, Estonisë, Letonisë dhe të disa vendeve të tjera të Europës Qendrore.

Iniciativa ligjore është në përputhje me objektivat e qeverisë dhe mbështet objektivat e përcaktuar në Planin Kombëtar të Integritetit 2019-2021 për kapitullin XXIV “Drejtësia, liria dhe siguria”, është pjesë e programit të përgjithshëm analitik të projektakteve të miratuara për vitin 2019.

Projektligji është miratuar nga grupi i punës, i ngritur me urdhër të Kryeministrit, dhe kanë marrë pjesë përfaqësues nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ministria e

Drejtësisë, Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Brendshme, Avokatura e Shtetit, Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave, Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara, Autoriteti i Kontrollit Shtetëror të Eksporteve, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, Banka e Shqipërisë, Prokuroria e Përgjithshme dhe Shërbimi Informativ Shtetëror. Nisur nga natyra e tij, ky projektligj nuk i nënshtrohet procesit të konsultimit publik, pasi është jashtë fushës së zbatimit të atij ligji.

Gjithashtu, projektligji nuk është akt që krijon të ardhura, por, nga ana tjetër, krijon edhe shpenzime minimale, pra shtohet vetëm një njeri në staf, i cili mirëmban pranë Ministrisë për Europën dhe Punët e Jashtme të gjithë *database-in* e masave shtrënguese dhe sanksioneve të vendosur nga Republika e Shqipërisë. Ligji paraqitet për miratim dhe kërkon mbështetjen tuaj për faktin se standardet ndërkombëtare dhe gjithë partnerët tanë ndërkombëtarë e kërkojnë dhe është i domosdoshëm për monitorimin e zbatimit të sanksioneve, si për luftën kundër financimit të terrorizmit, të armëve të shkatërrimit në masë apo edhe për mbrojtjen, respektimin e demokracisë, sanksione që, siç i kemi parë të gjithë, janë shtuar ndjeshëm në vitet e fundit.

Jam i gatshëm për çdo pyetje.

Faleminderit!

Ermonela Felaj – Faleminderit, zoti Xhafaj, për prezantimin e projektligjit!

Zonja Dralo fjala është për ju.

Artemis Dralo – Faleminderit, zonja kryetare,

Të nderuar kolegë,

Në fakt, për projektligjin e sotëm, ashtu siç e përmendi edhe zonja kryetare, kam qenë në drejtim në fillimin e hartimit të këtij projektligji. Ju përgëzoj për finalizimin e gjithë punës intensive, që grupi ndërinstytucional kishte ndërmarrë në vitin 2018. Me ato që zëvendësministri përmendi jam plotësisht dakord dhe më lejoni që të retaloj shkurt mbi disa detaje konkrete për këtë projektligj.

Qëllimi i këtij projektligji, ashtu siç u përmend, është zhvendosja dhe zbatimi i masave shtrënguese ndërkombëtare në funksion të ruajtjes së paqes dhe të sigurisë, parandalimit të konflikteve ndërkombëtare, mbështetjes dhe forcimit të demokracisë, sundimit të lirisë, të drejtave të njeriut, të gjitha këto në përputhje me rezolutat përkatëse të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, të akteve të organizatave të tjera ndërkombëtare, si dhe të marrëveshjeve të ndërkombëtare, ku Republika e Shqipërisë është palë.

Në fakt, Shqipëria i zbaton sanksionet ndërkombëtare, të cilat janë vendosur nga Këshilli i Sigurimit, si dhe masat shtrënguese të Bashkimit European, të cilat aktualisht ndiqen

në përputhje me angazhimet e politikës së jashtme të Shqipërisë, si rrjedhojë e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit, të vitit 2006, sipas nenit 8 të saj.

Aktualisht vendi zbaton këto masa shtrënguese ndërkombëtare, që janë ndërmarrë në kuadër të rezolutave të Këshillit të Sigurimit të Organizatës së Kombeve të Bashkuara, natyra e të cilave lidhet me terrorizmin apo me financimin e terrorizmit, i cili është i bazuar në ligjin nr. 157/2013 “Për masat kundër financimit të terrorizmit.” Megjithatë, duhet të përmendet se vërehet një boshllëk ligjor, i cili është i lidhur me masat shtrënguese, që nuk lidhen me terrorizmin apo me financimin e tij, por, në fakt, kanë të bëjnë me financimin e armëve të shkatërrimit në masë dhe me zbatimin e drejtpërdrejtë të rezolutave të dala në zbatim të kapitullit VIII të Kartës së Kombeve të Bashkuara për Ruajtjen e Paqes dhe të Sigurisë Ndërkombëtare.

Procedurat e zbatimit të masave shtrënguese, që nuk lidhen me terrorizmin apo edhe financimin e tij, nuk janë të përcaktuara me ligj apo në ligje specifike. Gjithashtu, edhe procedura e ankimit ndaj masave shtrënguese dhe listimet që mund t’i bëhen një personi juridik apo fizik për shkak të një mase shtrënguese, duke krijuar kështu një vakuum ligjor, me qëllim zbatimin nga Republika e Shqipërisë të masave shtrënguese ndërkombëtare, të cilat janë ndërmarrë në kuadër të rezolutave të Këshillit të Sigurimit, natyra e të cilave nuk lidhet me terrorizmin apo financimin e terrorizmit, kanë sjellë nevojën e krijimit të një baze ligjore për zbatimin e tyre.

Objekтиви kryesor i politikës, që propozohet me këtë projektligj është përcaktimi në mënyrë të detajuar i llojeve të sanksioneve ndërkombëtare, si edhe i procedurave, mekanizmave të vendosjes së këtyre sanksioneve, mekanizmave të zbatimit dhe monitorimit të masave shtrënguese, procedurave dhe mekanizmave të ankimit ndaj këtyre sanksioneve. Kjo politikë synon të kontribuojë në paqen dhe sigurinë ndërkombëtare, promovimin e respektit për të drejtën ndërkombëtare dhe të drejtat e njeriut, përkrahjen e parimeve demokratike dhe sundimin e ligjit. Gjithashtu, synon të zbatojë detyrimet që burojnë nga anëtarësimi i vendit tonë në organizata ndërkombëtare, si dhe nga dëshira për anëtarësim në këto organizata; të sigurojë zbatimin e efektshëm të masave, shtrënguese ndërkombëtare, me fokus parandalimin e përhapjes së armëve të shkatërrimit në masë duke ngrirë fondet dhe pasuritë e subjekteve përkatëse, si dhe të vendosë sanksione për subjektet që dështojnë t’u binden atyre.

Në fakt, ka ardhur një mendim nga Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejta e Njeriut, që iu ftoj ta diskutojmë në vazhdimësi.

Për sa thashë më sipër, ftoj të gjithë kolegët ta miratojnë këtë nismë mjaft të rëndësishme.

Faleminderit!

Ermonela Felaj – Faleminderit, zonja Dralo!

Në fakt, është e vërtetë që projekti i shqyrtuar nga Komisioni i Ligjeve dhe shpresoj që të gjithë kolegët e kanë përpara tabelën përkatëse të ndryshimeve të propozuara nga Komisioni i Ligjeve, të cilat ne si komision përgjegjës jemi të detyruar t'i marrim parasysh. Është e qartë që është një projekt që e detyron Shqipërinë të zbatojë praktika të ngjashme ose të njëjta ndërkombëtare njësoj si vendet e tjera të Organizatës të Kombeve të Bashkuara. Kjo është pjesa kryesore, në rast të kërcënimeve që cenojnë paqen në vend.

Fjala është për kolegët, në qoftë se kanë ndonjë pyetje për prezantuesin e projektit dhe për relatoren.

Urdhëroni, zoti Zeneli!

Alban Zeneli- Faleminderit, zonja kryetare!

Jam shumë dakord me çdo projektligj, që vjen në lidhje me mbrojtjen e interesave jo vetëm të shqiptarëve, por të të gjitha vendeve.

Kam një pyetje në lidhje me pikën 3 “Masat shtrënguese ndërkombëtare”, sepse përveç të tjerave kemi edhe masa shtrënguese të karakterit diplomatik dhe ushtarak. Dua të di: a i keni përcaktuar se cilat janë masat që merren në këtë rast, apo do ta shikoni më vonë?

Faleminderit!

Ermonela Felaj – Faleminderit!

Urdhëroni, zoti Xhafaj!

Etjen Xhafaj – Faleminderit për pyetjen!

Absolutisht, përveç pjesës së rezolutave dhe masave shtrënguese, të cilat janë parashikuar nga konventat e miratuara nga Këshilli i Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, do të ketë edhe mekanizma të tjerë brenda vendit, të cilët do të rregullohen me akte nënligjore, që besoj se do të vijnë deri në fund të vitit, sepse kështu është detyrimi në vijim të këtij ligji.

Ermonela Felaj – Urdhëroni!

Alban Zeneli – Faleminderit!

A mundet që ne t'i përcaktojmë masat brenda e këtij ligji, që të mos e lëmë hapësira, sepse shpeshherë ligje të veçanta që i ka bërë parlamenti shqiptar, ku kam votuar unë bashkë me kolegët e mi, ndodh që kanë qenë në kundërshtim me ligjet e miratuara. Mendimi im është që të ishin përcaktuar ato masa ose parimet kryesore të atyre masave, të ky projektligj që do të miratojmë.

Faleminderit!

Ermonela Felaj – Besoj se ka nevojë për një sqarim të mëtejshëm, nëse kuadri i masave shtrënguese mund të ezaurohet në ligj apo të lihet i hapur.

Etjen Xhafaj – Në nenin 5 “Llojet e masave shtrënguese” janë përshkruar të gjitha llojet e masave shtrënguese, që nga ndërprerja e marrëdhënieve diplomatike deri te bllokimi i aseteve apo ndalimi i hyrjes, kalimit, ndërprerja e korrespondencave, e telekomunikacionit, masat shtrënguese financiare, marrëdhëniet ekonomike. Masat e tjera shtrënguese, është pika 8, e cila do të specifikojë më tepër. Duke qenë se ligji po vendos një mekanizëm, i cili deri tani nuk ekzistonte, rrjedhimisht do t’i ketë diçka që do të mbështetet specifikisht për sa i përket pikës 8.

Ermonela Felaj - Faleminderit!

Nuk e di zonja Dralo, a keni një përgjigje për pyetjen e kolegut Zeneli?

Artemis Dralo - Në fakt, është ajo që sapo sqaroi zëvendësministri, duke qenë edhe në brendësi të saj. Pra, janë të përmendura masat shtrënguese, të cilat do të merren është marrë parasysh edhe lloji i penalizmit që do të bëhet. Për sa i përket pjesës ushtarake, në fakt, duhet specifikuar dhe unë e mbështes sugjerimin, që të bëhet një klauzolë, e cila të sqarojë se çfarë penalizmi do të kishte.

Nuk e di, nëse më lejoni: të bëj një pyetje?

Ermonela Felaj – Po.

Artemis Dralo - Te pjesa e financimit, pra nuk është një projektligj, i cili sjellë të ardhura financiare, por, nga ana tjetër, ka disa shpenzime. Në kuadër të këtij projektligji është parashikuar krijimi i një pozicioni specialisti pranë Ministrisë për Europën dhe Punët e Jashtme, i cili do të ketë përgjegjësi për ndjekjen e procedurës së ekzekutimit të sanksioneve dhe për realizimin e raportimeve.

Gjithashtu, keni përmendur edhe një pagë bruto për këtë person. Ajo që dua t’ju pyes është: mbi çfarë kriteresh bazë do të bëhet rekrutimi i këtij personi? Domethënë, nga cila fushë dhe për si do të rekrutohet një person i vetëm përgjegjës, që do të ketë më pas përgjegjësinë për plotësimin e regjistrit të të dhënave.

Faleminderit!

Ermonela Felaj – A keni një përgjigje për këtë, zoti Xhafaj?

Urdhëroni!

Etjen Xhafaj – Absolutisht, duke qenë se nuk e lexova pikën 5 të nenit, që adreson edhe pyetjen e mëparshme të deputetit, është: “Ndalimi i transferimit të ndërmjetësimit, tregtimit, transportit, transmetimit të armëve dhe pajisjeve ushtarake, dhënies së asistencës

teknike dhe financiare në lidhje me armët dhe pajisjet ushtarake jashtë vendit”, në fakt e ezauron atë.

Aktualisht, ne kemi një drejtori, pra një strukturë, që është sektori i sigurisë pranë të cilit do të bashkohet një specialist, duke qenë se specialisti do të ketë prioritet mbajtjen e listës së vendeve ndaj të cilave ne kemi sanksione. Pra, nuk do të jetë një post ekzekutiv, do të jetë vetëm një post, i cili mban dhe regjistron sanksionet, nisin nga Ministria për Europën dhe Punët e Jashtme pastaj të gjitha institucionet e tjera, të cilat janë përfshirë, gjithashtu, në hartimin e këtij projektligji, do të përfshihen në implementimin e këtyre sanksioneve.

Ermonela Felaj- Zonja Dralo.

Artemis Dralo- Kam edhe diçka tjetër. Në një paragraf thuhet se sanksionet janë efektive kur zbatohen nga të gjitha shtetet. Çfarë masash janë parashikuar, qoftë edhe nga Këshilli i Sigurimit, për subjektet që nuk zbatojnë sanksionet?

Etjen Xhafaj- Në varësi të sanksioneve dhe në varësi të rëndësisë së tyre, zbatohen edhe masa, në qoftë se do të ketë. Pra, ka injorim të vullnetshëm të sanksioneve kur kemi të bëjmë me rastet kur ka aleanca rajonale, ku disa nga ato vende i injorojnë sanksionet, të cilat përgjithësisht kanë të bëjnë me embargot më shumë sesa me sanksionet dhe ka raste kur është e paqëndrueshme kjo, siç është rasti aktual i Republikës së Shqipërisë në lidhje me një masë të këtij lloji, që është iniciuar nga Bashkimi Europian në lidhje me një vend tjetër në Europë, ku për pamundësi dhe për mungesë të bazës ligjore Shqipëria nuk i ka implementuar ato sanksione. Pra, në rast se kemi thyerje embargoje, ka mekanizma specifike, të cilët janë adresuar nga Karta e Kombeve të Bashkuara, në raste të tjera, kur këto nuk janë detyruese, ajo bëhet në mënyrë bilaterale nga vendet kryesore të Bashkimit Europian në rastin specifik, sepse Shqipëria i është bazuar apo bashkuar iniciativës për vendosjen e sanksioneve dhe, në rastin konkret, nuk ka pasur mundësi, në mungesë të bazës ligjore, për ta implementuar.

Ermonela Felaj – Fjalën e ka zoti Braho, pastaj zonja Gjebrea.

Spartak Braho – Pa u zgjatur te rëndësia e miratimit të projektligjit, sepse për këtë foli relatorja dhe përfaqësuesi i ministrisë, dua të nënvizoj faktin që unë kam qenë pjesë e diskutimit të këtij projektligji në Komisionin e Ligjeve, ku janë bërë disa vërejtje dhe ka kaluar. Të kalojmë te miratimi dhe ta mbyllim këtë histori.

Ermonela Felaj- Faleminderit, zoti Braho!

Megjithatë, kolegët kanë të drejtë të bëjnë pyetje, sepse ata po e shohin për herë të parë këtë projektligj.

Zonja Gjebrea, fjala për ju.

Elona Gjebrea- Faleminderit, zonja kryetare!

I nderuar zoti Zëvendësministër,

Të nderuar punonjës të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Çështjet e Europës,

Sigurisht, është për t'u vlerësuar shumë që sot vjen ky projektligj për masat shtrënguese ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë. Në fakt, ky është një vakum i krijuar prej shumë kohësh, një kontradiktë dhe paqartësi për sa i përket detyrimit që ka Shqipëria për zbatimin e konventave dhe kur ndesheshim në praktikë me situata nga më të ndryshmet. Kështu që ky projektligj do të përmbushë një boshllëk dhe, sigurisht, mezi pres që në raportimet e radhës ne të shikojmë sesi do të jetë zbatimi i këtij projektligji.

Kam dy sugjerime të vogla, që nuk kanë ndonjë rëndësi të madhe.

Në radhë të parë kam një pyetje. Në relacionin tuaj, që është relacion i detajuar, për hir të së vërtetës është hera e parë që shoh një relacion që ka bibliografi brenda, ka detaje, ndoshta në këndvështrimin tim kështu siç vjen te ne, pak të tepruara, por që nuk bëjnë keq për të kuptuar më mirë se çfarë sjellë ky projektligj. Ju përmendni vazhdimisht pjesën e kostos dhe pjesën e impaktit që vjen nga vendosja e masave shtrënguese tek ekonomitë e vendeve vendosëse, për të cilën mendoj se do të ishte mirë të na e shpjegonit me 2-3 fjali, pasi në mënyrë të vazhdueshme përmenden faqet 3, 9 dhe 11 (kur thoni opsioni 1 dhe 2, pra, kosto), ndërkohë që flisni konkretisht për një shtim stafi me detaje dhe flisni në mënyrë të përgjithshme që, sipas mendimit tim, nuk kuptohet mirë.

Së dyti, ju thoni se ky ligj është i ngjashëm me disa vende, ku keni rreshtuar vendet, si: Kroacia, Serbia, Maqedonia, Kosova, Çekia, Estonia dhe Letonia. Jam kurioze të di si e kanë ligjin vendet fqinje, si: Italia, Greqia dhe Franca dhe, nuk është e thënë që të gjitha vendet duhet t'i kenë ligjet e mira, pse keni shkuar aq larg, te Estonia dhe Letonia?

Duke ju falënderoj për punën e bërë, pres përgjigjen!

Ermonela Felaj- Faleminderit, zonja Gjebrea.

Besoj se pyetjet e zonjës Gjebrea janë të qarta për ju.

Zoti Xhafaj.

Etjen Xhafaj –Faleminderit, zonja kryetare!

Faleminderit, zonja deputete, për pyetjet!

Për sa i përket pyetjes së parë, ka të bëjë me efektet e sanksioneve në rastin e bllokadave apo embargoeve, të cilat bllokojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë shkëmbimet ekonomike apo financiare mes dy vendeve, të cilat kanë një efekt të ndjeshëm ekonomik. Në qoftë se marrim rastin e sanksioneve që janë vendosur aktualisht ndaj Iranit, për të gjitha vendet që kanë shkëmbime ekonomike apo tregtare me atë, ka pasur një impakt të drejtpërdrejtë, i cili shtrihet

edhe tek ekonomia e vendit që inicion apo implementon masat shtrënguese dhe jo vetëm tek ai, mbi të cilin këto masa vendosen.

Për sa i përket pyetjes lidhur me vendet e rajonit, ne kemi marrë si shembull vendet e rajonit dhe vendet balltike duke qenë se janë vende, të cilat e kanë bërë më vonë dhe nga masa apo nga fuqia e tyre nuk janë anëtare të G7-ës, sepse mekanizmat e implementimit nga një vend apo ekonomi si Italia janë shumë të zhvilluar dhe shumë më progresivë sesa mund të jenë ato nga vende si Shqipëria. Për këtë është synuar brenda këtij projektligji, të merreshin shembuj nga vende, të cilat krahasoheshin qoftë nga përbërja demografike, qoftë nga fuqia ekonomie dhe nga madhësia gjeografike për të parë mundësitë tona dhe për të mos tentuar ta vendosnim veten në vend të një nga superfuqive botërore, qoftë ekonomike, qoftë ushtarake. Ne kemi marrë shembuj vendet anëtare të BE-së, vendet, të cilat janë në të njëjtën rrugë për sa i përket integritimit europian me ne dhe vende që i kanë hapur negociatat ose vende që janë në të njëjtin stad, në mënyrë që të shohim edhe zhvillimin e procesit dhe impaktin që ky projektligj do të kishte mbi këtë proces.

Elona Gjebrea- Faleminderit!

U sqarova nga përgjigjja e dhënë, por, meqenëse ju thoni se ka lidhje me bllokimin e shkëmbimeve ekonomike, besoj se është i qartë funksioni i ekonomisë përkatëse, sepse këtu thuhet që është krijuar një komitet, ku besoj se në aktet nënligjore që do të krijoni do të sqaroni se cili është detyrimi dhe si ndodh koordinimi. Mendoj se këto janë shumë çështje delikate dhe detyrimet e çdo institucioni duhet të jenë shumë qartë të përcaktuara.

Faleminderit!

Etjen Xhafaj – Një pjesë sqarohet këtu dhe një pjesë do të sqarohet më shumë me ngritjen e komitetit, sepse do të ketë edhe masa dhe ajo që ofron projektligji është edhe krijimi i masave që inician nga vetë qeveria shqiptare apo komiteti.

Ermonela Felaj – Faleminderit, zoti Xhafaj!

Fjalën e ka zonja Dhima, pastaj kalojmë në votimin në parim.

Antoneta Dhima- Faleminderit, zonja kryetare!

Faleminderit, zoti Zëvendësministër, për prezantimin!

Është shumë e rëndësishme që ne po diskutojmë një projektligj, i cili ka për qëllim ruajtjen e paqes dhe sigurisë në vend.

Objektivi i këtij projektligji është përmbushja e detyrimeve që vendi ynë ka, si vend anëtar i Kombeve të Bashkuara, zbatimeve të rezolutave të OKB-së, të Kartës së Kombeve të Bashkuara, si dhe rekomandimeve të Task-Forcës për veprim financiar për sa i përket luftës

kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, kryesisht në rekomandimin e gjashtë dhe të shtatë.

Në nenin 21, te aktet nënligjore, janë disa pika, të cilat kanë një afat zbatimi 6 muaj. A i keni parë këto afate në përputhje me paketën MONEYVAL, të cilën ne e kemi miratuar në parlament?

Faleminderit!

Ermonela Felaj- Ideja është se para pak kohësh ne miratuam një paketë të disa ndryshimeve të sugjeruara nga Komiteti MONEYVAL, kështu që këto çfarë përcjellë projektligji për masat shtrënguese ndërkombëtare a janë në përputhshmëri me atë çfarë ne kemi miratuar dhe kemi ndryshuar?

Etjen Xhafaj – Absolutisht, sepse ai ka qenë detyrim edhe për Ministrinë për Europën dhe Punët e Jashtme, madje ky ligj, pavarësisht se është zhvilluar dhe punuar gjatë të gjithë këtij viti, duhet të kishte kaluar që vjet. Ne kemi punuar për përgatitjen e akteve nënligjore, që do të vijnë në vijim të këtij ligji dhe, sapo të votohet në seancë, do të kalojmë menjëherë te kalimi i tyre, duke qenë se edhe afati është deri në fund të vitit, edhe për arsyet që përmendet ju, pra shtrëngesat dhe detyrimet që kemi si vijim i komenteve të MONEYVAL-it.

Ermonela Felaj- Faleminderit!

Atëherë, kalojmë në votimin në parim.

Kush është dakord me miratimin në parim të projektligjit “Për masat shtrënguese ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë? Kundër nuk ka. Abstenim nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë në diskutimin nën për nen të projektligjit.

Të nderuar kolegë, ju lutem mbajeni përpara tabelën e ndryshimeve që janë propozuar nga Komisioni i Ligjeve!

Neni 1 i projektligjit përcakton qëllimin e projektligjit, për të cilin nuk ka pasur asnjë sugjerim për ndonjë ndryshim të mundshëm nga ana e Komisionit të Ligjeve. A ka ndonjë ndërhyrje nga anëtarët e komisionit për këtë nen? Jo, nuk ka.

Kush është dakord me neni 1? Kundër nuk ka. Abstenim nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë në nenin 2 të projektligjit, që është objekti.

Në nenin 2 ka vetëm një ndryshim në ato që propozon Komisioni i Ligjeve, ku fjala “rregullon” zëvendësohet me fjalën “përcakton”. Pra, propozimi që vjen nga Ministria për Europën dhe Punët e Jashtme është që ky ligj rregullon procedurën e vendosjes së zbatimit të ndryshimit me radhë të masave shtrënguese ndërkombëtare, ndërkohë që kolegët tanë të

Komisionit të Ligjeve sugjerojnë që ky term “rregullon” të zëvendësohet me termin “përcakton”, duke thënë: “Ky ligj përcakton procedurën”.

Dua të dëgjoj mendimin e zotit Xhafaj për këtë ndryshim të vogël.

Etjen Xhafaj- Ne kemi rënë dakord me ndryshimin, duke qenë se nuk ndryshon asgjë nga substanca e nenit apo nga përmbajtja e tij.

Ermonela Felaj- Dakord. Besoj se edhe kolegët e komisionit nuk kanë ndonjë vërejtje. Jemi dakord me atë çfarë ka sugjeruar Komisioni i Ligjeve. Kush është dakord me miratimin e nenit 2, sipas propozimit të bërë nga Komisioni i Ligjeve? Kundër nuk ka. Abstenim nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë te neni 3, i cili ka lidhje me fushën e zbatimit. Nga Komisioni i Ligjeve nuk ka ndonjë sugjerim për këtë nen. A ka ndonjë ndërhyrje për përmbajtjen e këtij neni? Ligji i është i qartë dhe parashikon rrethin e subjekteve ndaj të cilëve do të zbatohen masat shtrënguese ndërkombëtare, që nisin nga shtetet dhe përfundojnë tek entitetet. Kush është dakord me nenin 3? Kundër nuk ka. Abstenim nuk ka.

Miratohet.

Neni 4 përmban përkufizimet e të gjithë termave që përdoren në këtë projektligj. Nga Komisioni i Ligjeve ka një sugjerim për të ndryshuar dy pika të këtyre propozimeve, pikën 4, ku bëhet fjalë për përkufizimin e shprehjes “Entitet” dhe pikën 10, ku ka rregullim të shprehjes “Organizime ligjore”.

Zoti Xhafaj, a mund ta dimë qëndrimin tuaj që keni pasur në komision për këto dy sugjerime?

Etjen Xhafaj- Për sa i përket pikës 10, ne jemi plotësisht dakord, duke qenë se nuk ndryshon asgjë nga substanca.

Për sa i përket pikës 4, ne nuk jemi dakord, sepse i gjithë përkufizimi për “entitetin” ka ardhur nga Drejtoria e Parandalimit të Pastrimit të Parave, që është një nga strukturat, të cilat identifikojnë subjektet që përbëjnë objektin e këtij ligji dhe, nga ana tjetër, është një nga implementuesit primarë të këtij ligji, i cili zbaton të gjitha normat dhe rregulloret ndërkombëtare mbi këto. Për rrjedhojë, ne mendojmë që duhet të mbetet siç është vendosur nga autoriteti kompetent për këtë specifikë.

Ermonela Felaj- Po, zonja Gjebrea.

Elona Gjebrea – Pse duhet ta vendosim në numrin njëjës fjalën “entitet”, domethënë nuk nënkupton një grupim dhe nëse ka një grupim shoqatash nuk merret në konsideratë?

Etjen Xhafaj - Duke qenë se është neni i përkufizimeve, përgjithësisht përdoret numri njëjës për të specifikuar gjithë ciklin, pastaj aplikimi është i njëjtë si në njëjës, ashtu edhe në

shumës. Kjo është teknikë legjislative, por nuk është një gjë që ndryshon thelbin e trajtimit ligjor.

Elona Gjebrea –Unë nuk jam juriste dhe nuk më takon të insistoj në një gjë që nuk e njoh shumë mirë, por mendoj se nuk është e njëjta logjikë që ruhet në të gjitha përcaktimet. Kjo ndërhyrje ishte thjesht për t’ju ndihmuar në rast se mund të luhet nesër ose pasnesër me këtë gjë.

Ermonela Felaj - Neni 5 bën fjalë për llojet e masave shtrënguese. Nga Komisioni i Ligjeve nuk kam asnjë sugjerim. A ka ndonjë merak nga kolegët e komisionit për këtë nen, megjithëse nga pyetjet u sqarua se cilat janë masat shtrënguese ndërkombëtare? Domethënë, janë ato masa që përdoren në vende të tjera anëtare të Organizatës së Kombeve të Bashkuara. Kush është dakord me nenin 5? Kundër nuk ka. Abstenim nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë te neni 6. Ky nen përfaqëson fillimin e kreut II të projektligjit, “Vendosja, zbatimi, ndryshimi dhe shfuqizimi i masave shtrënguese”. Nga Komisioni i Ligjeve ka vetëm një reflektim. Meqenëse ramë dakord që në vend të fjalës “rregullon” të përdorim fjalën “përcakton” është vetëm ky sugjerim. Nuk ka ndonjë sugjerim tjetër.

Më falni!

Ka një sugjerim për riformulimin e pikës 1 të nenit 6 : “Këshilli i Ministrave miraton, vendos që ndryshimi dhe shfuqizimi i masave shtrënguese ndërkombëtare në mbledhjen e tij të parë të radhës...” Jo, kjo është në rregull.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Pika 1, germa “a”. “Dispozitat e këtij neni rregullojnë procedurat e vendosjes, zbatimin, ndryshimin dhe shfuqizimin e masave shtrënguese të parashikuara në germat “b” dhe “c” të pikës 3 të nenit 3 të këtij ligji”. Nuk ka ndryshuar ndonjë gjë. Pra, është vetëm një fjalë, meqenëse ramë dakord më parë, besoj se nuk keni vërejtje as për nenin 6.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Kur të shkojmë në fund e shikojmë. Për afatet do të flasim te dispozita që na ofron të gjitha afatet. Duke pasur parasysh teknikën ligjore nuk shkruhen afatet për çdo akt nënligjor aty ku neni flet për të, por në fund fare te dispozitat transitorë flitet edhe për këtë gjë. Pra, e diskutojmë atje çështjen e afateve. Kush është dakord me nenin 6? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 7 “Zbatimi i ndryshimeve dhe shfuqizimi i masave shtrënguese”. Nga Komisioni i Ligjeve kemi një riformulim të pikës 5 të këtij neni. Shprehimisht na sugjerohet që pika 5 të

reformulohet në këtë mënyrë: “Për qëllime të zbatimit të pikës 4 të këtij neni organet përgjegjëse kanë detyrimin që t’i propozojnë Këshillit të Ministrave nxjerrjen e akteve nënligjore ose të nxjerrin vetë akte nënligjore me karakter të brendshëm”. Cili është qëndrimi i përfaqësuesve të ministrisë?

Ilir Bajraba - Jemi dakord.

Ermonela Felaj - Po, zonja Gjebrea.

Elona Gjebrea – Nuk e kuptoj logjikën, pse duhet ta kemi.

Ermonela Felaj- Edhe mua nuk më bën sens. Se çfarë janë aktet nënligjore të brendshme, unë po i dëgjoj për herë të parë. Është fjala për rendin më të ulët, për udhëzime e të tjera me radhë që i nxjerr ministri? Ato i përcakton Kushtetuta.

Ilir Bajraba - Jo. Ka të bëjë me ato me karakter të brendshëm, pra iniciativat tona, jo vetëm...

Ermonela Felaj – Dakord, ju e keni thënë te propozimi juaj: “Organet kanë të drejtë që t’i propozojnë Këshillit të Ministrave nxjerrjen e akteve nënligjore ose të nxjerrin vetë akte nënligjore me karakter të brendshëm”. Se kush i nxjerr, e ka Kushtetuta, si dhe çfarë lloj akti nxjerr, pse duhet që ta specifikojmë ne? Kështu siç ka ardhur është korrekt. Besoj se ka edhe mbështetjen e anëtarëve të komisionit.

Kush është dakord me nenin 7, siç është propozuar? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 8 “Bllokimi i përkohshëm”. Nuk ka sugjerime nga Komisioni i Ligjeve për këtë nen. Nuk e di nëse kolegët kanë ndonjë gjë për të thënë?

Kush është dakord me nenin 8? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 9 “Masa shtrënguese ndërkombëtare me karakter të brendshëm”. Ka një sugjerim për pikën 2 të këtij neni, ku përmendet për herë të parë sipas Komisionit të Ligjeve termi “komitet” të përkufizohet. Nuk e di se çfarë qëndrimi ka Ministria për Europën dhe Punët e Jashtme? Personalisht nuk jam dakord. Është një term i natyrës së përgjithshme dhe nuk mund të përkufizohet termi “komitet”.

Po, zonja Shahaj.

Shpresa Shahaj - Faleminderit!

Edhe ne nuk jemi dakord me sugjerimin e bërë nga Komisioni i Ligjeve për faktin se ka një nen specifik që përcakton se cili është komiteti, është neni i mëposhtëm. Është e vërtetë

se në nenin që i referohet Komisioni i Ligjeve përdoret termi “komitet” për herë të parë, por do të ishte ngarkesë e ligjit të shpjegonim çdo fjalë...

Ermonela Felaj - Po, është e vërtetë.

Shpresa Shahaj - Ne nuk jemi shprehur dakord.

Ermonela Felaj - Është një sugjerim i panevojshëm. Kush është dakord me nenin 9 siç është propozuar nga Ministria për Europën dhe Punët e Jashtme? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 10, i cili bën fjalë për detyrat, funksionin, si dhe përbërjen e këtij komiteti. Komisioni i Ligjeve ka bërë një riorganizim të këtij neni, që nuk është se ndryshon gjë në thelb. Pra, është operuar duke treguar se si përbëhet ky komitet dhe se çfarë funksionesh ka ai. Nga ministria vjen një propozim, mua më duket i natyrës pak më praktike, sepse na tregon direkt se çfarë bën komiteti. Pastaj vjen përbërja që duket një gjë më dytësore në raport me detyrat. Personalisht unë do të votoja për variantin e përcjellë nga ministria.

Po, zonja Gjebrea.

Elona Gjebrea - Edhe unë jam për variantin e propozuar nga ministria, sepse duhet të kuptojmë një herë detyrat që ka komiteti, që pastaj të ketë logjikë, se cilët janë përfaqësuesit e këtij komiteti. Nëse i vendos përpara, humbet logjika.

Grua – Edhe unë mbështes propozimin e ministrisë, sepse kjo sjell një çorientim të gjitha pikave më poshtë, me ripërsëritje të të njëjtit informacion. I qëndroj propozimit të ministrisë, si për renditjen ashtu edhe për përbërjen.

Ermonela Felaj - Kush është dakord me nenin 10 sipas propozimit të Ministrisë për Europën dhe Punët e Jashtme? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 11, i cili bën fjalë për organet përgjegjëse që do të kenë detyrimin për të zbatuar masa shtrënguese ndërkombëtare për qëllime të këtij ligji. Rendi i organeve është ndërtuar në mënyrë hierarkike, fillon me Ministrinë për Europën dhe Punët e Jashtme dhe vazhdon me ministritë e tjera, Ministrinë e Brendshme, Ministrinë e Financave, Ministrinë për Ekonominë. Ministrinë për Kulturën dhe Shkencën, Ministrinë për Arsimin e me radhë.

Komisioni i Ligjeve ka sugjeruar disa riformulime, riformulimin i germës “c”, të pikës 1 të nenit 11. Po kështu edhe germa “e” e pikës 2 të nenit 11 është propozuar të riformulohet. A mund të dimë më parë qëndrimin e ministrisë, që të njoftohemi paraprakisht se çfarë diskutimi kanë pasur?

Ilir Bajraba – Qëllimi ynë ka qenë t’u referohemi atyre që janë autoritete specifike dhe të mos flasim për kompetencat e tyre specifike, sidomos për sa i përket AMF-së që ka një portofol shumë të mirëpërcaktuar, por që ndryshon në varësi të gjërave të reja që shtohen në atë fushë.

Për sa i përket germës “c” kjo ka qenë arsyeja pse ne kemi vendosur t’i kemi të cituara ato të cilat janë institucione që ekzistojnë.

Ermonela Felaj - Edhe për kolegët, është e qartë se Ministria për Europën dhe Punët e Jashtme i është referuar Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare ashtu sikundër ky autoritet emërtohet sot, nuk i është referuar sipas përgjegjësisë funksionale që ka ky autoritet, që faktikisht nuk është objekt i këtij ligji, thjesht merr detyrime si autoritet çfarëdolloj fushe përgjegjësie të ketë nesër. Ky është qëndrimi i ministrisë.

Po, zonja Gjebrea për sugjerimin tuaj.

Elona Gjebrea – Më duket se nuk ka njeri që ka punuar te Ministria e Brendshme në Komisionin e Ligjeve, sepse Ministria përgjegjëse për Punët e Brendshme ka edhe institucione varësie, të cilat nuk janë të përmendura këtu, përmendet Ministria e Mbrojtjes dhe institucionet e varësisë dhe policia që është institucion i varësisë së Ministrisë së Brendshme nuk është përmendur. Pra, sugjeroj të thuhet: “Ministria e përgjegjëse për Punët e Brendshme, institucionet e varësisë”. Të gjitha institucionet e tjera përmendin dhe strukturat e varësisë.

Ermonela Felaj - Dakord, duket që ka një diferencë, sepse në çdo rast që i jeni referuar një ministrie, i keni përfshirë edhe institucionet vartëse të tyre. Jemi dakord që ta shkruajmë njëjloj për çdo germë? Të reflektojmë sugjerimin e zonjës Gjebrea. Nuk kam një përgjigje nga ana juaj për qëndrimin në lidhje me sugjerimin e bërë nga Komisioni i Ligjeve për pikën 2 të nenit 1.

Po, zonja Shahaj.

Shpresa Shahaj - Edhe për germën “e” qëndrimi i ministrisë mbështet propozimin e përcjellë në projektligj, për faktin se pjesa e ankimeve administrative ndaj vendimeve është një procedurë që rregullohet në një ligj të veçantë dhe do të ishte e tepërt të përsërisnim çfarë Kodi të Procedurës Administrative kanë referuar kolegët e Komisionit të Ligjeve të vendosej edhe në ligjin “Për masat shtrënguese ndërkombëtare”.

Ermonela Felaj - Faleminderit, zonja Shahaj!

A ka ndonjë qëndrim nga kolegët për këtë gjë?

Meqenëse qëllimi i ligjit është që të përcaktojë organet përgjegjëse dhe thjesht t’i rendisë ato dhe jo të shkojë më tej, se çfarë bëjnë, sepse në lexim e sipër ligji humbet edhe

përmbajtjen e tij, unë personalisht jam që ne t'i qëndrojmë mendimit që ka shprehur në projektligj Ministria për Europën dhe Punët e Jashtme, duke sugjeruar vërejtjen që bëri zonja Gjebrea, të cilës dua t'i shtoj dhe faktin se kudo ku përmenden sugjerime për riformulime apo për ndryshime të neneve dhe ka referenca në germa, fjala “shkronjë”, të zëvendësohet me fjalën “germë”. Kjo është përgjithësisht gjuha që kemi përdorur në projekte.

Kush është dakord me nenin 11 me këto që thamë? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 12 “Blokimi i aseteve dhe i fondeve”. Nuk ka ndonjë sugjerim nga Komisioni i Ligjeve. Kolegët, a kanë ndonjë gjë për të sqaruar? Pika 2 e këtij neni reflekton komplet ndryshimet që kemi diskutuar te paketa MONEYVAL, që bllokimi bëhet pa vonesë dhe pa njoftim paraprak të subjekteve. Nëse diskutuam për faktin që Ministria i kishte pasur parasysh apo jo ndryshimet e sjella në paketën MONEYVAL, ky nen e tregon: po është e vërtetë.

Kush është dakord me nenin 12? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 13 “Lejimi i përdorimit të aseteve të bllokuara”, që është vijim i së njëjtës logjikë. A ka vërejtje? Nuk ka. Kush është dakord me nenin 13? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 14 “Përpunimi i të dhënave”. Nuk ka vërejtje nga Komisioni i Ligjeve, por ka zonja Gjebrea një ndërhyrje.

Elona Gjebrea – Ne e miratuam, por kam diçka për nenin 13, nëse më lejohet, sepse më kaloi shpejt. Kam një pyetje.

Ermonela Felaj - Po, dakord.

Elona Gjebrea - Zoti Zëvendësministër, aty ku bëhet fjalë për ilaçet, trajtimin mjekësor, neni 13, pika 2, mos duhet ta theksojmë: “Në institucione shtetërore dhe private”?

Ermonela Felaj – “Gjykata mund të lejojë që asetet e bllokuara të lirohen ose të vihen në dispozicion nëse vërtetohet se asetet janë të domosdoshme për mbulimin e kostove themelore të jetesës, qirasë apo hipotekës së banesës, ilaçet, trajtimin mjekësor, taksat dhe sigurimet ose shpenzimet e shërbimeve publike”.

Elona Gjebrea - Futen edhe shërbimet publike? Në rregull.

Ermonela Felaj - Për nenin 14, ka vërejtje? Kush është dakord me nenin 14? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 15 “Regjistri i të dhënave”. Kam sugjerimin e Komisionit të Ligjeve, që shprehja “regjistri i të dhënave” të përfshihet te neni 4, “Përkufizimet” duke thënë: “Regjistri i të dhënave përfaqëson regjistrin në të cilin reflektohet përpunimi i të dhënave për vendosjen, zbatimin, ndryshimin dhe shfuqizimin e masave shtrënguese ndërkombëtare. Regjistri mbahet nga Ministria përgjegjëse për Europën dhe Punët e Jashtme”. Ministria i qëndron të njëjtës logjikë se jo çdo gjë duhet të përkufizohet te “Përkufizimet”, sepse thjesht e rëndojmë ligjin.

Ilir Bajraba - Në praktikën tonë kur përmenden terma të tillë specifikë, pra do të ngrihet një regjistër që është diçka e re që nuk ka ekzistuar më parë dhe duke qenë se ligji nuk bëhet vetëm për ekspertët e fushës, por edhe për qytetarët e zakonshëm, ne kemi gjykuar gjithnjë si të dobishme që të përkufizohen, qoftë kur është një komitet ndërministror, sepse edhe komiteti ndërministror është i përveçëm, ai komitet ekziston vetëm për qëllimin e këtij ligji. Ne nuk e kishim për fjalën “komitet” në vetvete. E njëjta logjikë edhe këtu, pra kur përdoret një regjistër kaq i rëndësishëm në ligj për qytetarët që e lexojnë ligjin mendojmë se është e dobishme dhe e kemi rekomanduar në të gjitha projektligjet e tjera.

Ermonela Felaj - Po, zonja Gjebrea.

Elona Gjebrea – Meqenëse ju thatë se bëhet edhe për qytetarët që lexojnë ligjin, qytetarët lexojnë regjistrin, nuk sqarohen, por shkojnë te sqarime, shikojnë se çfarë është regjistri dhe kthehen mbrapsht. Kjo për mua krijon konfuzion. Nuk na kushton asgjë të themi: “të përcaktuara” dhe shkojmë direkt tek ajo për të cilën bëhet fjalë, te regjistri i të dhënave. Nëse thonë: “regjistri” duhet të kthehemi edhe një herë mbrapsht dhe për mua kjo krijon vështirësi, sikurse “komiteti” shkon direkt dhe targeton se për çfarë bëhet fjalë dhe nuk ke nevojë të kthehesh mbrapsht dhe të lexosh “komitetin”. Ky është sugjerimi im. Megjithatë këto janë përcaktime juridike, që ju i dini më mirë.

Ermonela Felaj - Kush është dakord me variantin e propozuar nga Komisioni i Ligjeve? Zoti Braho. Kundër? Rrëzohet sugjerimi i Komisionit të Ligjeve. Kush është dakord me nenin 15, siç është propozuar nga Ministria për Europën dhe Punët e Jashtme.

Kundër? Abstenim? 1.

Po, faleminderit!

Miratohet!

Kalojmë te neni 16: “E drejta për informim”

Ka vërejtje nga kolegët, për këtë nen?

Po, zonja Gjebrea.

Elona Gjebrea – Duke lexuar këtë nen, vihet re se është shumë i përgjithshëm. Në fakt, nuk e sqaron tamam: çdo subjekt i interesuar, po për çfarë? Mbase duhet sqaruar kjo gjë. Pastaj të themi: “gëzon të drejtën e informimit”, e të tjera e të tjera.

Ermonela Felaj – Po, zoti Xhafaj. Keni ndonjë përgjigje për këtë?

Shpresa Shahaj – Në fakt, pikërisht ky është qëllimi: të mos kufizojmë se kush ka të drejtë të informohet në lidhje me masat shtrënguese ndërkombëtare, për të mos i mohuar askujt të drejtën për t’u informuar, qofshin këto edhe masa shtrënguese ndërkombëtare. Në funksion të kësaj do të jetë edhe krijimi i regjistratit, i që do të jetë publik, sa u takon llojeve të masave, subjektet ndaj të cilëve janë vendosur masat.

Etjen Xhafaj – Vlerësohet se transparenca është një nga domosdoshmëritë këtu, prandaj dhe është lënë e përgjithshme, për të krijuar idenë se të gjitha kanë mundësinë të informohen për sa vijon

Ermonela Felaj – Sidoqoftë, ligji për të drejtën e informimit, që është një ligj më specifik, e garanton këtë të drejtë, kështu që ky është një afirmim i ligjit.

Kush është dakord me nenin 16?

Po, faleminderit! Kundër? S’ka. Abstenime s’ka.

Miratohet!

Neni 17: “Publikimi i masave shtrënguese ndërkombëtare”

Pa ua dhënë fjalën kolegëve, besoj se ka vend vetëm për një ndërhyrje në aspektin gjuhësor. Fjala “vendimi”, që është në njëjës, duhet bërë në shumës. Po ashtu, edhe fjala “publikohet” kthehet në shumës: “publikohen”. Pra: “Rezoluta dhe vendimet e Këshillit të Ministrave publikohen në faqen zyrtare të ministrisë.”

Dakord me këtë ndryshim? Atëherë, kush është dakord me nenin 17?

Faleminderit!

Kundër s’ka. Abstenime s’ka.

Miratohet!

Kalojmë te neni 18, që është: “E drejta për ankim”.

Vijmë te subjektet ndaj të cilëve zbatohen këto masa, që natyrisht kanë edhe ato të drejtën e tyre, si çdo subjekt tjetër, që për masat shtrënguese të ndjekin rrugët e ankimit. Afati është ai i përgjithshmi, 30 ditë. Nuk ka mbërritur nga komisioni i Ligjeve, për këtë nen.

Kush është dakord me nenin 18?

Faleminderit!

Kundër s’ka. Abstenime s’ka.

Miratohet!

Kemi nenin 19: “Masa ndëshkuese”

(Ndërhyrje pa mikrofon)

E ka vënë te përkufizimet.

Atëherë, masat ndëshkuese. Nga ligjet kemi vetëm këtë riformulim për pikën 6 të këtij neni, i cili bën fjalë për procedurat e shqyrtimit të ankimit dhe ekzekutimit të vendimeve për kundërvajtjet administrative, që bëhen në përputhje me legjislacionin për kundërvajtjet administrative. Ndërkohë, ligjet sugjerojnë se: “Kundër vendimit të organeve përgjegjëse për zbatimin e masave shtrënguese ndërkombëtare, subjektet, pasi kanë shteruar të gjitha mjetet e ankimit administrativ, mund të paraqesin ankim pranë Gjykatës Administrative, në përputhje me rregullat e parashikuara nga legjislacioni në fuqi për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative.

Do të na interesonte të dinim nëse ministria ka qenë dakord me këtë riformulim?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, nuk është e ngatërruar. Është në rregull.

Etjen Xhafaj – Ne nuk kemi qenë dakord me këtë, duke qenë se fillon me idenë e kundërt dhe krijon idenë e një mase, që po bëhet... Ndërkohë, e gjithë përmbajtja e ligjit bazohet në ruajtjen e ca të drejtave e parimeve ndërkombëtare. Gjuha specifike aty është pak më e ashpër nga ç’do të donim ne, por nuk është se ndryshon gjë në thelb.

Faleminderit, zoti Xhafaj!

Do të doja të dija qëndrimin e kolegut Vorpsi, meqë ndërhyri.

Sadi Vorpsi – Më duket gjuhë shumë teknike, ndaj jam dakord me mendimin e Ministrisë së Jashtme.

Ermonela Felaj – Ka ndonjë vërejtje, ndonjë sugjerim tjetër në lidhje me këtë, nga ana e kolegëve?

Ndryshimi nuk është thelbësor. Thjesht një ligj është, për masat shtrënguese të karakterit ndërkombëtar. A duhet të operojmë me një përcaktim, që në fakt e përmbajnë ligje të tjera, të cilat janë të natyrës më civile? Pra, ligjet sugjerojnë, që këtu, kushdo që e lexon ligjin të shohë edhe rrugën se si mund ta bëjë ankimin ndaj masave shtrënguese me karakter ndërkombëtar. Ndërkohë, ministria gjykon se nuk është vendi për të bërë detajime kaq të hollësishme, sepse ligji është i një natyre paksa të ndryshme nga sa përmbajnë ligjet në përgjithësi.

Nuk e di me cilin qëndrim do të ishin kolegët.

Zoti Braho më ndihmon, e pastaj do ta hedhim në votim.

Spartak Braho – Ministria e ka pranuar formulimin në Komisionin e Ligjeve. Le të mos u hyjmë këtyre hollësirave, sepse këto janë kaq specifike, kaq profesionale, sa treçereku i atyre që jemi këtu nuk i kuptojmë. Dakord?

Ermonela Felaj – Atëherë, ju jeni i mendimit që t’i rrimë propozimit të Komisionit të Ligjeve.

Zonja Dhima.

Antoneta Dhima – Te kjo pika 3, organi përgjegjës vlerëson se është bërë konstatuar shkelje dhe vendos gjobën nga 50 mijë deri në 10 milionë lekë. Është një hapësirë shumë e madhe midis minimumit dhe maksimumit.

Ermonela Felaj – Po, është e vërtetë. Çfarë qëndrimi kemi nga ana e ministrisë në lidhje me këtë rast?

Shpresa Shahaj – Në fakt, ne i jemi referuar edhe akteve të tjera ligjore, që rregullojnë vendosjen e masave administrative, të cilat kanë të bëjnë pikërisht me respektimin e sanksioneve. Është ligji “Për parandalimin dhe pastrimin e parave”, është ligji “Për parandalimin e financimit të terrorizmit.”

Gjithashtu, ky ka qenë një sugjerim edhe i Ministrisë së Drejtësisë, si pjesë e grupit të punës. Është e njëjta diferencë, ashtu siç është te ligji “Për parandalimin e pastrimit të parave”, e që u pa së fundmi edhe te ligji 157 të 2013 –ës “Për parandalimin e financimit të terrorizmit”. Kemi mbajtur të njëjtën linjë.

Ermonela Felaj – Për sugjerimin e bërë nga Komisioni i Ligjeve në lidhje me këtë formulim të nenit 20, keni një qëndrim? Ju keni dashur të thoni se kjo është taksative dhe se në asnjë rast nuk ka kompensim? Apo ka edhe raste kur ka kompensim?

Etjen Xhafaj – Ka raste kur ka kompensim, në qoftë se gabimi bëhet me qëllim apo pa qëllim. Pra, nëse kemi një ngatërrim me emrin, mbiemrin, një nga shkronjat, që ne i kemi rëndom, dhe dënohet apo sanksionohet personi i gabuar, gjë që e ngriti edhe nënkryetarja e parlamentit në seancën e Komisionit të Ligjeve. Desha të shpjegoja vetëm diçka. Edhe ne, sot i kemi parë, nuk është se na janë sjellë komentet në lidhje me këtë specifikë, duke qenë se këtu ishte rënë dakord që të kishte një lëvizje nga njëri nen në tjetrin, për t’u plotësuar neni 20.

Ermonela Felaj – Po, zonja Shahaj.

Shpresa Shahaj – Në fakt, sugjerimin e kolegëve e pamë në Komisionin e Ligjeve. Në fakt bën sens që ose të hiqet neni 20, siç është sugjerimi i Komisionit të Ligjeve, dhe të shtohet kjo pikë te neni 18, ose të mbajmë nenin 20 dhe pas presjes së fundit të shtojmë: “përveç rasteve kur dëmi është shkaktuar me qëllim apo me faj nga ky i fundit”.

Do të sugjeronim opsionin e propozuar nga Komisioni i Ligjeve, që kjo pikë t'i bashkohet nenit 18, ndërsa neni 20 të hiqet fare.

Ilir Bajraba – Zonja kryetare.

Ermonela Felaj – Po.

Ilir Bajraba – Atëherë, siç është diskutuar në komision, ashtu si është neni 20 bie në kundërshtim me pikën 4 të nenit 18, sepse pika 4 e nenit 18 e përjashton dhe thotë: “përveç rasteve kur dëmi është shkaktuar me qëllim apo me faj nga Republika e Shqipërisë”. Ndërkohë, neni 20 përjashtohet. Pra, përjashtohen edhe këto dy raste. Rekomandimi i Komisionit të Ligjeve ka qenë se është i mjaftueshëm neni 19 në lidhje me kërkesën për kompensim, por nëse edhe ministria do të insistojë që neni 20 të qëndrojë, në fund duhet shtuar pjesa: “përveç rasteve kur”.

Ermonela Felaj – Po, zonja Gjebrea.

Elona Gjebrea – Kam një pyetje për zotërinë nga Komisioni i Ligjeve.

Atëherë, në qoftë se kjo do të jetë me variantin e kalimit të nenit 18, titulli i nenit a do të jetë njësoj apo do të shtohet dhe kompensim? Titulli i nenit është: “E drejta për ankim”. Në qoftë se ju thoni se neni 20 inkorporohet te neni 18, titulli do të jetë: “ankimim dhe kompensim”, apo jo? Kjo është pyetja.

Ilir Bajraba – Sa për sqarim, qëndrimi i komisionit nuk ka qenë që neni 20 të inkorporohet te neni 18, por që nenin 18 është mjaftueshëm, ndërsa neni 20 është i panevojshëm, dhe përveç kësaj bie edhe në kundërshtim me nenin 19.

Ermonela Felaj – Në rregull! Faleminderit!

Të nderuar kolegë, bën sens që neni 20 të mos përsërisë atë që ka thënë neni 18. Deri këtu do të bija dakord me kolegët e mi të ligjeve. Edhe një argument tjetër: po t'i referohemi Kodit Civil, nuk ka kërkesa për kompensim, por kërkesa për dëmshpërblim, dhe përdorimi i shprehjes “me qëllim apo me faj” nuk është korrekt, sepse dëmi është me faj ose pa faj. Kështu që, ta lëmë pikën 4 të nenit 18, duke e korrigjuar dhe duke thënë se është shkaktuar me faj nga ky i fundit, ndërsa nenin 20 ta heqim fare, si të panevojshëm.

Neni 18 është një nen i përgjithshëm. Ka ankesë edhe për dëmin, veç të tjerave. Neni 18 e thotë shprehimisht, se ti mund të shkosh në gjykatë vetëm për dëmin që shkaktohet me faj. Në raste të tjera nuk mund të shkosh në gjykatë. Kur ankohesh për dëmin, kërkon edhe dëmshpërblimin.

Më ndihmoni, sepse jeni nga drejtoria juridike, por Kodi Civil nuk ka padi në lidhje me të drejtën për kompensim, po për dëmshpërblim. Nuk përdoret fjala kompensim. Dakord? Që

të mos e rendisim aty çdo gjë që ka anën e vet subjektive, se pastaj do të thoshim: qëllimi, motivi, faji e të gjitha me radhë.

Atëherë, kush është dakord që të reflektojmë një ndryshim në pikën 4 të nenit 18? Ndërkohë, neni 20 të hiqet, si një nen i panevojshëm?

Faleminderit!

Miratohet!

Kalojmë te neni 21, që për efekt të rinumërimit të ligjit do të bëhet neni 20. Me këtë lidhet edhe diskutimi që pati zonja Dhima pak më herët, nëse afati gjashtëmuor duket afat i arsyeshëm për të bërë gjithë korpusin e akteve nënligjore, që detyron ky projektligj. Pra, ju mjaftojnë gjashtë muaj, apo kjo mund të bëhet edhe për tre muaj? Që të jemi praktikë, sepse nëse nuk bëhet për tre muaj, nuk do t'ju themi të vini prapë në komision, që të ndryshoni afatin.

Etjen Xhafaj – Kam përshtypjen se nuk është edhe aq punë dëshire e ministrisë sonë, sa ç'është domosdoshmëri për të mbyllur para dhjetorit edhe aktet. Afati maksimal që i kemi lënë vetes është gjashtë muaj, por synimi është ta mbyllim për tre muaj.

Ermonela Felaj – Atëherë do ta bëjmë tre. Përndryshe, po nuk e bëmë ne tre, nuk bëhet kjo.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nga hyrja në fuqi e ligjit.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ju lutem, do t'i them edhe stafit të komisionit, këto presjet që janë përdorur këtu vend e pa vend të hiqen. Janë nja katër presje që duhen hequr: “Ngarkohet Këshilli i ministrave presje që presje brenda gjashtë presje muajve presje.”

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nëse është detyrim që ne duhet ta bëjmë edhe miratimin e këtij ligji, është një detyrim në kuadër të integritetit. Mirë është që ta vendosim që këtë afat ta vendosim tremujor, dhe le të bëhet projekti.

Atëherë, kush është dakord që neni 20 të bëhet neni 21 dhe afati gjashtëmuor të bëhet tremujor? Faleminderit!

Kundër s'ka. Abstenime s'ka.

Miratohet!

Kush është dakord me nenin 22, i cili rinumërohet si neni 21, për hyrjen e ligjit në fuqi, që është afati i zakonshëm?

Miratohet edhe kjo!

Faleminderit!

Kalojmë në votimin e fundit, që është miratimi në tërësi.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Kolegë, u miratua!

Kush është dakord me miratimin në tërësi të ligjit “Për masat shtrënguese ndërkombëtare”?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ata kanë bërë ligjin. Nuk bëjnë dot se nga cilët përbëhet komiteti apo çfarë detyrash do të ketë komiteti.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Mirë. Bëjmë votimin, se kush është dakord.

Ka një ndërhyrje.

Shpresa Shahaj – Për të qenë realistë, ne do të mundohemi t’i bëjmë deri në dhjetor, sepse më 16-17 dhjetor kemi një raportim për MONEYVAL –in, lidhur me miratimin e ligjit dhe akteve nënligjore. Ideja është të bëhet brenda gjashtë muajve, për të qenë korrekt, sepse këto nuk janë akte që do të kërkojnë vetëm përfshirjen e Ministrisë për Europën dhe Punët e Jashtme, por janë të gjitha të gjitha institucionet. Duke marrë në konsideratë faktin se për të bërë këtë ligj, gjë që relatorja e di shumë mirë, kemi hequr shumë për të mbledhur grupet e punës. Kjo sepse komiteti është një strukturë, e cila do të implikojë veprimtarinë e shumë institucioneve. Ministria e Jashtme nuk mund të marrë përsipër se si do të funksionojnë Ministria e Financave apo Ministria e Mbrojtjes në zbatim të këtij ligji.

Pra, për të qenë fleksibël në lidhje me çfarë na lejohej, kemi parashikuar afatin gjashtëmuajor. Ju siguroj se, duam apo s’duam, aktet do të miratohen deri në dhjetor, sepse duhet të shkojmë me paketën e plotë, por do të sugjeroja që të afati qëndrojë gjashtë muaj.

Jeni në rregull me afatin, sepse nuk i bie në dhjetor tremujori, por më vonë, sepse është tre muaj nga hyrja e ligjit në fuqi. Kështu që, me këtë afat shkoni deri në shkurt. Në rregull?

Faleminderit për prezencën tuaj në komision, si dhe për bashkëpunimin që patëm.

Kolegë, nesër shihemi në Shkodër, te takimi në Drejtorinë e Policisë Shkodër. Ndërkohë, kam vetëm një njoftim për ata që janë të interesuar. Këto ditë vjen në Shqipëri nga Republika franceze, një trupë përfaqësuesish të një instituti të lartë për mbrojtjen, nga. Ata kanë kërkuar një takim me kolegët e këtij komisioni, në orën 12 të ditës së shtunë. Nëse ndokush do të jetë i lirë për t’u angazhuar në këtë takim, ju lutem ta konfirmoni këtë pranë stafit të komisionit, që të njoftojmë edhe ambasadën franceze në lidhje me grupin e kolegëve që do të përfaqësojnë Komisionin e Sigurisë.

Faleminderit!

MBYLLET MBLEDHJA